



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 12, datë 16.06.2022

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin qershor, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 18:20

Data e mbajtjes së mbledhjes : 16.06.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Radhe

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi: Përshëndetje ! Të nderuar Këshilltarë! E nderuar Kryetare!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë radhe për muajin qershor të Këshillit Bashkiak Durrës.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë dhe nga 2 Komisione të Përhershëm të Këshillit, projektvendime që kanë të bëjnë më fatkeqësinë natyrore të tërmetit të datës 26 nëntor 2019 . I gjithë dokumentacioni ju është vënë në dispozicion në postën elektronike nga Sekretarja e Këshillit. Ftoj Sekretaren e Këshillit të bëj prezencën në sallë.

Dorina Milja: Përshëndetje! Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja...prezent.

Kryetar ke 27 këshilltarë në sallë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit !

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojme me mbledhjen.

Para se të fillojmë me leximin e pikave të rendit të ditës ju bëj me dije se nga 18 vendime që kemi marrë mbledhjen e kaluar nga VKB nr.44 deri 61 për Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.58, datë 31.05.2022 “Për miratimin për dhënien në përdorim, pa kundërshtim, Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Kulturës Durrës, të pronës me emërtimin “vendstrehim”, me sipërfaqe të përgjithshme 155 m² (nga kjo sipërfaqe nën objekt 95 m² dhe sipërfaqe funksionale 60 m²), në inventar të Ndërmarrjes Rruga, pronë e bashkisë, që mban nr. 256 të listës së pronave, transferuar me VKM-në nr. 536, datë 01.05.2008, me vendodhje në lagjen nr. 1, rruga “Taulantia”, zk 8512, për t’u përdorur për magazinim të objekteve të trashëgimisë kulturore, për një afat 1 vit, me të drejtë përsëritje”, Prefekti i Qarkut Durrës me shkresë nr.474/15 prot, datë 07.06.2022, marrë ë dorëzim nga Sekretaria e Këshillit më datë 15.06.2022, është është shprehur se ky vendim është i pabazuar në ligj, pasi sipas Ligjit nr.27/2018 “Për trashëgimi kulturore dhe Muzetë” Muzeu Kombëtar i Arkeologjisë dhe Parku Arkeologjik Durrës janë në Administrim të Qendrës Muzeore Durrës (QMD) dhe jo Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Kulturës Durrës. Kjo ishte për dijeni për këshilltarët. Përsa i përket shkresës së Prefektit mendoj se është një lapsus në emërtimin e Qendrës, pas ndryshimeve përkatëse do ta kalojmë sigurisht në mbledhjet e radhës.

Atëherë fillojmë më leximin e pikave të rendit të ditës.

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË TABELËS SË DETAJIMIT TË FONDIT, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 40, DATË 09.05.2022 “PËR MIRATIMIN E DETAJIMIT TË FONDIT PREJ 2’303’173’480 LEKË PA TVSH NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.181, DATË 30.03.2022 “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË, DURRËS, SHIJAK, LEZHË DHE KRUIË” PËR SHKAK TË NJË GABIMI MATERIAL
Pika 2 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN NR. 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 30, DATË 26.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1032, RRUGA “ALEKS KOMNENI” DHE PALLATIN “KASTRATI” RRUGA “RAMADAN VELIU” TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, DUKE PËRFSHIRË ZNJ. FATBARDHA SHEHU
Pika 3 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN NR. 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 77, DATË 28.06.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 3, 5, 7, RRUGA “BASHKIMI”, PALLATI NR. 1, RRUGA “DEMOKRACIA” PALLATI NR.2/1, RRUGA “PROGRESIT”, PALLATI NR. 6, RRUGA “MILENIUMI” DHE

	PALLATI NR.4, RRUGA “MINIERËS” NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, DUKE PËRFSHIRË Z. ADEM KACULI
Pika 4 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË ANEKSIN NR. 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 22, DATË 25.02.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1062, RRUGA “26 NËNTORI” DHE PALLATIN NR. 14, RRUGA “PETRAQ BOSHNJAKU” NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 2, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, LIDHUR ME NDRYSHIMIN E STRUKTURËS SË BANIMIT TË PËRFITUAR NGA Z. AVDUL VELIAJ
Pika 5 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të paraqitur nga 2 Komisione të Përhershëm të Këshillit	PËR MIRATIMIN E NJË SHITESË NË ANEKSIN NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 22, DATË 25.02.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1062, RRUGA “26 NËNTORI” DHE PALLATIN NR. 14, RRUGA “PETRAQ BOSHNJAKU” NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 2, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, DUKE PËRFSHIRË Z. FATMIR TAULLAI
Pika 6 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të paraqitur nga 2 Komisione të Përhershëm të Këshillit	PËR MIRATIMIN E NJË SHITESË NË ANEKSIN NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 22, DATË 25.02.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1062, RRUGA “26 NËNTORI” DHE PALLATIN NR. 14, RRUGA “PETRAQ BOSHNJAKU” NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 2, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, DUKE PËRFSHIRË Z. ZYHDI SHQIOPA
Pika 7 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË TABELËS SË DETAJIMIT TË FONDIT, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.42, DATË 09.05.2022 PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT DHE DETAJIMIT TË FONDIT PREJ 1.633.906.424 LEKË PA TVSH NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.255, DATË 29.04.2022 “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË DURRËS” PËR SHKAK TË NJË GABIMI MATERIAL

Atëherë ka ndonjë koment për sa i përket rendit të ditës nga ana këshilltarëve?

Nuk ka komente, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Kundra?

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 27 vota pro miratohet rendi i ditës.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Etleva Velçani.

Etleva Velçani : Faleminderit Kryetar.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës dhe vendosi me shumicë votash kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit znj. Velçani

Komisioni Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj. Morena Boja.

Morena Boja : Po, faleminderit.

Atëherë Komisioni Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave Vendore pasi mori në shqyrtim këtë pikë të rendit të ditës vendosi pro kalimit të saj në mbledhjen e këshillit bashkiak.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Boja.

Atëherë komente përse i përket pikës 1, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 27 vota pro miratohet dhe pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin për **pikën 2**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

Alneida Rroshi : Faleminderit Kryetar

Komisioni Rregullores, Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim pikën 2 të rendit të ditës propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Rroshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini : Gjithashtu dhe Komisioni ynë me vota unanime propozon për kalimin në votim të kësaj pike në mbledhjen e këshillit bashkiak. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Budini.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani : Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin vendosi për kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Velçani.

Ndonjë koment përsa i përket pikës 2, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 27 vota pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 3**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi: Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim dhe pikën 3 të rendit të ditës në mënyrë unanime propozon për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

Etleva Budini: Edhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike pasi shqyrtoi relacionin për pikën 3 të rendit të ditës votoi unanimitisht për kalimin në mbledhjen e sotme.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Budini.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani: Gjithashtu dhe Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin vendosi kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Velçani.

Përsa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë me 27 vota pro miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 4**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi: Edhe për pikën 4, Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

Etleva Budini: Gjithashtu edhe Komisioni ynë votoi unanimitisht për kalimin në votim të pikës 4 të rendit të ditës në mbledhjen e sotme. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani: Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin vendosi me vota unanime kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Velçani.

Përsa i përket pikës 4, kemi komente nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë miratohet me 27 vota pro dhe pika 4 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 5**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

Alneida Rroshi: Kam vetëm 1 pyetje, nëse mund të më thuash nëse pika 5 bën fjalë për familjen Taullai apo Shqiopa, Kryetar?

Ani Dyrmishi : Pika 5 bën fjalë për familjen Taullai.

Alneida Rroshi: Faleminderit Kryetar.

Atëherë Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi mori në shqyrtim kërkesën me nr.5365 prot., datë 13.06.2022 të kryetares së Bashkisë Durrës, bazuar në Rregulloren e Këshillit për familjen Taullai ka rezultuar jo përfitues në programin e rindërtimit nëpërmjet Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 22 datë 25.02.2021 duke mos u përfshirë në listën e përfituesve me arsyen se rezulton me një banesë të dytë.

Në trajtim të kërkesës së depozituar dhe raportit të Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, në funksion të nenin 36 të Rregullores së Këshillit Bashkiak Durrës, Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore si dhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike të Këshillit Bashkiak Durrës morën në trajtim rastin e familjes Taullai.

Nga rezultatet, nga dokumentacioni pasi morëm në shqyrtim rezulton se pretendimet e ankimesit lidhen me arsyetimin e disa banesave. Bëhet fjalë për një apartament prej 49 m², që nuk ndodhet në bashkinë Durrës, por në bashkinë Kavajë duke mos përfshirë dhe standartet e mirëpërcaktuara përse i përket gjëndjes familjare sipas çertifikatës në momentin që ka ndodh

fatkeqësia natyrore. Apartamenti i cili është pjesë e bashkëpronësisë, vlerësuar edhe në funksion të përbërjes familjare, prej 6 personash i bie 8 m² për secilin. Pra kjo bie në kushdërshtim edhe me vetë legjislacionin në fushën e strehimit ku norma është e përcaktuar në masën 30 m², kjo sipas VKM nr. 301, datë 15.04.2020.

Në vazhdim sqarojmë se të dy apartamentet ku pronar është ankimuesi së bashku me familjes e tij sipas çertifikatës familjare ndodhen në të njëjtin pallat të dëmtuar apo shembur për të cilin pretendojnë të marrin vetëm njërin prej tyre. Pra ankimuesi është në kushtet e mospasjes së një banese për të jetuar normalisht.

Pas rezultatetve dhe pretendimeve nga ASHK-ja ku njëri bashkë, një nga personat që ndodhen në çertifikatën familjare kishin dhe një pronë tjetër, aty bëhet fjalë për një truall dhe jo apartament.

Nisur nga këto kushte komisioni ynë duke trajtuar në vijim ekzistencën e përbërjes familjare në momentin e aplikimit që ka qenë prej 6 personash, i referohen kësaj përbërjeje familjare duke propozuar Këshillit Bashkiak Durrës që kjo praktikë të miratohet lidhur me përfshirjen e z.Fatmir Taullai në listën e përfituesve në masën e strukturës 3+1. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Roshi.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini: Të gjithë anëtarët e Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike bashkë me Komisionin e Rregullores, Çështjeve Ligjore jemi konsultuar e shqyrtuar me orë të gjata dhe kemi votuar unanimisht që ky propozim të kaloj për votim në këtë mbledhje.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Atëherë komente përsa i përket pikës 5, nga ana e këshilltarëve kemi?

Artion Beqiraj : Më fal, kisha unë një.

Ani Dyrmishi : Po, z. Beqiraj.

Artion Beqiraj : Nisur dhe nga raste të tjera që kemi diskutuar në Këshillin Bashkiak lidhur me banesat e qytetatarëve që ndodhen në pallatet e shëmbura, nga pikpamja ime e kemi diskutuar dhe dje me anëtarë të këshillit, personat të cilët ndërtesat u ndërtohen në truallin ku ishin banesat e tyre të mëparshme duhet të jenë përfitues edhe pse mund të kenë banesa të tjera. Unë vet personalisht nuk e shikoj përjashtuese dispozitën e nenit 5 pika 3 dhe 4 të aktit normativ që thotë : *“..Nuk është subjekt përfitues individ ose familja që ka në pronësi ose posedim”* .. etj etj. Këtu thotë që nuk është përfitues subjekti, por nuk thotë për asgjë, për banesë, për grant, për qera, pra nuk e specifikon, e lë të hapur.

Po të shikojmë më poshtë tek i njëjti akt normativ nr.9, neni 21, pika 2, thotë: *“Përfitues të njëjësive të banimit në objektet e reja janë pronarët e njëjësive të banimit të objekteve të shëmbura, në trojet e të cilave ndërtohen objektet e reja....”*. Po ashtu ka një VKM të mëpasshme që ka dal po në zbatim të këtij akti normativ bëhet fjalë për një akt më specifik, bëhet fjalë pikërisht për

neni 20.1 të VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019 e cila thotë :.. “Familjet, që kanë humbur banesat si pasojë e shembjeve të ndërtesave (pallateve), përfitojnë nga :

a) programi i zhvillimit të zonave të reja

b) programi i rindërtimit të godinave në të njëjtin truall

c) programi i fondit të banesave. ...” pastaj vazhdon dispozita.

Pra edhe sipas kësaj VKM-je familjet që kanë humbur banesat si pasojë e shëmbjes së godinave me Vendim të Këshillit Bashkiak, por aty ndërtohet objekte ata do të jenë përfitues mjafton tek njëri nga programet, pra jo fare nga programet siç ka qënë e diskutueshme, por njërin nga programet duhet ta përfitoj. Në këtë rast duke qënë se kemi një dispozitë të posaçme, “Ne” që jemi jurist e dimë këtë, se dispozitat e posaçme prevalojnë mbi dispozitat e përgjithshme siç ishte dhe neni i mëparshëm. Në pikpamjen time të gjithë banorët që u janë prishur banesat në pallatet e shëmbura dhe aty ndërtohet në të njëjtin truall nuk kufizohen në pronësi, për tu rikthyer pronësinë. Pastaj po t’i hymë pastaj trajtimeve që ka vendimmarrjen gjykata, kufizimi i pronës është hallka e fundit, nuk mund të bëhen kufizime vetëm sepse ke një shtëpi, nuk është arsye ligjore. Dhe prandaj Akti Normativ është korrigjuar më pas me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Në pikpamjen time ka patur një koncept disi pengues, që ka qënë koncepti i akteve me karakter social. Këto fillimisht duhet të trajtohen si akte me karakter social se zgjidhen qerat, zgjidhen emergjencat, por janë akte që në fund fare kanë qëllim pronësor. Pra, nëqoftëse do jepte shpinë më akt, do ta hiqte shpinë me akt, është akt me karakter pronësor, ka mbaruar karakteri social. Pra, t’i do projektosh vendimin si do shkoj çështja e pronësisë. Dhe rasti konkret për ta mbyllur ky është mendimi im dhe për rastin që citoj Alneida dhe për arsye të tjera me sa kuptova, por kur qytetarit në truallin ku e ka patur shtëpinë i rindërtohet pallat qytetari duhet të jetë përfitues. Raste të tjera pastaj hajt t’i shqyrtojmë, ky ishte mendimi im. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit z. Beqiraj.

Ndonjë koment tjetër kemi?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Me 27 vota pro miratohet dhe pika 5 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 6**, i japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Faleminderit Kryetar.

Përsa i përket pikës 6, pikës 7, ndjesë, bëhet fjalë për familjen Shqiopa që ka rezultuar jo përfitues në programin e rindërtimit nëpërmjet Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.22 datë 25.02.2021 duke mos u përfshirë në listën e përfituesve me arsyen se rezulton me një banesë të dytë. Nga dokumentacioni në shqyrtim rezulton se pretendimet e ankimesit lidhen me arsyetimin se:

Për pasuritë që rezultojnë se është pronar, z.Shqiopa ka paraqitur ekstraktin nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numrin unik të identifikimit dhe fusha e veprimtarisë dhoma me qera. Gjithashtu ka paraqitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Çertifikatë kategorizimi strukturë akomoduese për subjektin Shqiopa.

Për sa më sipër, pretendon se pavarësisht se në çertifikatën e pronësisë pasuritë janë apartament, familja e tij ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese.

Pra ankimesi është në kushtet e mospasjes së një banese për të jetuar normalisht.

I ndodhur në këto kushte Komisioni pasi e ka shqyrtuar sipas *strukturës së njësisë së banimit që do t'i kalohet përfituesve nuk duhet të jetë më e madhe se struktura e njësisë së banimit që përfituesi kishte në pronësi në objektin e shembur*, Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore si dhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike i referohen strukturës së banimit që ka pasur më herët duke propozuar Këshillit Bashkiak Durrës që kjo praktikë të miratohet lidhur me përfshirjen e z.Zyhdi Shqiopa në listën e përfituesve në masën e strukturës 2+1. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj.Rroshi.

I japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Budini.

Etleva Budini : Edhe për Komisionin tonë ka qënë shumë i qartë ky rasti i familjes Shqiopa. Apartamenteve shtesë për të cilat nuk ka dal fitues në listën e parë, janë të strukturave akomoduese. Me dokumenta të cilat ka paraqitur edhe Komisioni i Posaçëm por dhe vet familjari vërtetohet që janë njësi biznesi. Apartamenti i vetëm në të cilin kanë banuar është apartamenti, që ndodhej në pallatin që është shembur nr.1062. Kështu që Komisioni jonë votoi unanimisht për të kaluar për votim për 2+1 këtë familje.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Budini.

Atëherë përse i përket pikës 6, ka komente nga ana e këshilltarëve?

Artion Beqiraj : Po, kam unë.

Ani Dyrmishi : Po, z. Beqiraj.

Artion Beqiraj: I kishte struktura akomoduese dhe si i tillë paguan taksë fjetje. Përderisa pagon taks fjetje dhe në paketën fiskale janë njësi biznesi. “Ne” për banesat tona nuk paguajmë taksë fjetje. Atëherë përderisa ai paguan taksë fjetje bashkisë, atëherë nuk futen si banesa të zakonshme. Duhet të kaloj.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Ndonjë koment tjetër kemi?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Me 27 vota pro miratohet dhe pika 6 e rendit ditës.

- Kalojmë në projektvendimin të **pikës 7**, i japim fjalën Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Etleva Velçani.

Etleva Velçani : Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin vendosi me shumicë votash kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Faleminderit znj. Velçani

Komisioni Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj. Morena Boja.

Morena Boja : Edhe Komisioni Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave Vendore pasi mori në shqyrtim projektvendimin dhe relacionin vendosi pro kalimit të pikës 7 për votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit znj. Boja.

Komente përse i përket pikës 7, kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Me 27 vota pro miratohet dhe pika 7 e rendit ditës.

Ani Dyrmishi: Meqenëse asnjë nga këshilltarët nuk ka kërkuar fjalën për diskutim, as kryetarja se ka kërkuar. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit për pjesmarrjen. Faleminderit Kryetare. Takohemi në mbledhjen e ardhshme.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 10 (dhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit, sipas Rregullores Këshillit dhe Procesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.

Mbajtësi i procesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Zëvendëskryetare e Këshillit :

ZAMIRA MUSTAFARAJ

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI